

VENDIM
Nr.589, datë 18.8.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.840, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR VENDOSJEN E KABLLIT NËNDETAR NDËRKOMBËTAR ME
FIBËR OPTIKE BARI (ITALI)- GJIRI I LALZIT (SHQIPËRI) (PROJEKTI BALKANS-
ITALY NETWORK)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr.840, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Afati i kësaj lejeje, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është deri në datën 28 shkurt 2013.”.

2.Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha